



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 268 / prot. 1

Tiranë më 20.2.2018

VENDIM

Nr. 08, datë 20.2.2018

PËR

REFUZIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV

Në mbështetje të nenit 135, pikës 2 të nenit 136 dhe pikës 2 të nenit 137 të Kodit të Procedurave Administrative,

KONSTATOVA SE :

Pranë Zyrës së Komisionerit është depozituar ankimi administrativ nga Shoqëria "A.KeR" sh.p.k, me nr. K82303012A NUIS, përfaqësuar me prokurë nga Av. dhe me objekt: Anulimi /shfuqizimi i aktit administrativ "Vendimi nr. 01, datë 29.01.2018 i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Zyra e Komisionerit, pasi u njoh me ankimin administrativ të depozituar, bazuar në nenin 135 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA) i cili parashikon se:

"Ankesa është e pranueshme nëse plotëson këto kushte:

- a) nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji;*
- b) ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 128 të këtij Kodi;*
- c) është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 132 i këtij Kodi; dhe*
- ç) çfarëdo kushti tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj".*

konstaton se, shoqëria "A. KeR" sh.p.k, nuk përmbush kushtet e nenit 135 të KPA-së për ushtrimin e këtij ankimi administrativ. Ankuesi nuk rezulton të ketë legjitimitet për ushtrimin e ankimit administrativ pranë Zyrës së Komisionerit për arsye se shoqëria "A.KeR" sh.p.k, nuk ka qenë palë e procesit të shqyrtimit administrativ.

Neni 33 i Kodit të Procedurës Administrative parashikon se: *"Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:*

- a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;*

- b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose
- c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative

Palë e këtij procesi administrativ kanë qenë, ankuesi z. _____, i cili ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, formularin e Ankesës nr. 1522 Prot., datë 21.11.2017, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", dhe Autoriteti Publik, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA).

Zyra e Komisionerit në zhvillimin e seancës dëgjimore çmoi të arsyeshme pjesëmarrjen e ankuesit z. _____ dhe Autoritetit Publik si organi ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, duke qenë se koncepti i gërmimit arkeologjik është hartuar nga shoqëria e licensuar në bazë të kontratës trepalëshe me nr. 600 Prot datë 05.05.2017, midis Autoritetit Publik, shoqërisë "A. KeR" sh.p.k. në cilësinë e shoqërisë së licencuar dhe shoqërisë FAKLE sh.p.k. në cilësinë e investitorit të projektit, për llogari të Autoritetit Publik në përmbushje të një detyrimi ligjor që i buron këtij të fundit nga ligji.

Për sa më sipër, referuar pikës 2 të nenit 136, të Kodit të Procedurës Administrative i cili parashikon se: "Organi publik kompetent fillimisht shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, shqyrton ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ të ankimuar", Zyra e Komisionerit vlerëson se ankimi administrativ rezulton të jetë i papranueshëm.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 2 të nenit 137 të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S A:

1. Refuzimin e ankimit administrativ.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, sipas pikës 1 të nenit 18 të ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".
3. Ky vendim u shpall sot në datë 20.2.2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

